



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJE

Nr. \_\_\_\_ Prot

Lushnje, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje Gazoil , për nevojat e Shoqërisë”

“Marrvëshje Kuadër me një Operator Ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuar, me afat  
12 muaj”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
Naftë -091340007 Karburant -09134100-8

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 5 608 754 ( pesë milion e gjashtëqind e tetë mije e shtatëqind  
pesëdhjet e katër)Lekë pa Tvsh.

- I. Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Fondi limit është përlogaritur nga grupi i punës me Urdhër Nr. 13, date 13/01/2025.**

Në llogaritjen e vleres së Kontrates është marrë për bazë çmimi i njësisë të përlogaritur bazuar në të dhënat e botuar në buletin nga APP date 20.01.2025 dhe marzhi i fitimit si mesatare e tre ofertave, testim tregu.

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

---

#### **2.1. Kapacitetin profesional të Operatorëve Ekonomikë:**

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të Kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e Fondit Limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.*

#### **2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të Kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të Kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për Kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar Kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (lidhur me procedurën e hapur të thjeshtuar).

**Kopje te vërtetuar te bilanceve**, te audituara nga ekspertet kontabël te licencuar, te konfirmuara nga autoritetet përkatëset e Administratës Tatimore, **te tre vitevete fundit (2021, 2022, 2023)** ku te pakten ne dy bilancet e nje pasnjeshme, nuk ka raport negative ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit. Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, duhet te paraqitet nga Operatori Ekonomik vetem ne rastet kur jane ne kushtet e percaktuara nga neni 41, germa ‘c’ e ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (indryshuar”).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.*

---

## **Specifikimet teknike dhe profesionale**

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi te cilat duhet të përshkruajne minimumin ose tërësinë elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, te VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”, të ndryshuar , ne Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 147, datë 21.03.2007 për cilesin e lëndëve djegjeve, benzinë dhe diesel” dhe standarteve shtetore në fuqi SSH EN 590: 2013+A1:2017.

Për këtë objekt prokurimi Autoriteti Kontraktor ka përdorur Specifikimet Teknike duke ju referuar standarteve kombëtare te marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve. Funizimi me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil) duhet te kete këto karakteristika : Diezel, (Gazoil) të jëtë sipas standartit EN 590: 2013+A1:2017 , **ekuivalente** (te rinovuar) me certifikaten e njohur nga Standartet shqiptare SSH EN 590:2022

Specifikime të dhenat teknike të gazoil duhet ti referohen standartit european (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standartit shqiptar SSH EN 590:2013+A1:2017, **ose ekuivalente** (te rinovuar) me certifikaten e njohur nga Standartet shqiptare SSH EN 590:2022.

Operatorët Ekonomik janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kërkuar sipas standartit të kërkuar si me sipër :

---

Adresa : Lgj.18 Tetori, Rr. Vath Korreshi, pranë ish-parkut të mallrave

E-mail : [kontakt@ukl.al](mailto:kontakt@ukl.al) ;

NIPT : M24606401K

Kerkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave.

**Te dhenat teknike për karburantin të jenë sipas standarteve të përcaktuara nga Komuniteti European.**

Shënim: Sipas ISHTI, nuk lejohet tregëtimi i gazoilit me përmbajtje squfuri jo më të lartë se 10MG/kg, edhe për gjenator do të përdoret e njehta cilesi naftë bluediesiel

**Specifikimet Teknike për karburantin Gazoil D1 (10PPM ULSD) të jenë sipas standarteve të përcaktuara nga Komuniteti European.**

| Treguesi cilësor  | Njësia e matjes         | Normat e lejuara |            | Metoda e provës                              |
|---|-------------------------|------------------|------------|--|
|   |                         | minimale         | maksimale  |  |
| Numri i cetanit <sup>b</sup>  |                         | 51,0             | -          | EN ISO 5165<br>EN ISO 15195                  |
| Indeksi I cetanit   |                         | 46,0             | -          | EN ISO 4264                                  |
| Densiteti në 15 °C <sup>c</sup>   | kg/m <sup>3</sup>       | 820,0            | 845,0      | EN ISO 3675<br>EN ISO 12185                  |
| Hidrokarburët aromatikë policiklikë <sup>d</sup>  | % (m/m)                 | -                | 8,0        | EN 12916                                     |
| Përmbajtja e squfurit <sup>e</sup>  | mg/kg                   | -                | deri 10,0  | EN ISO 13032<br>EN ISO 20846<br>EN ISO 20884 |
| Pika e flakërimit   | °C                      | mbi 55           | -          | EN ISO 2719                                  |
| Mbetja e karbonit f (në 10 % mbetje distilimi)  | % (m/m)                 | -                | 0,30       | EN ISO 10370                                 |
| Përmbajtja e hirit  | % (m/m)                 | -                | 0,01       | EN ISO 6245                                  |
| Përmbajtja e ujit   | mg/kg                   | -                | 200        | EN ISO 12937                                 |
| Ndotja e përgjithshme   | mg/kg                   | -                | 24         | EN 12662 g                                   |
| Korrozioni I shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)   | klasifikimi             | kategoria 1      |            | EN ISO 2160                                  |
| <b>Përmbajtja e esterit të metilit të acidit yndor (FAME)</b>                                 | % (V/V)                 |                  | <b>7,0</b> | <b>EN 14078</b>                              |
| Qëndrueshmëria ndaj oksidimit   | g/m <sup>3</sup><br>ore | -<br>20          | 25         | EN ISO 12205<br>EN ISO 15751 i               |
| Vetitë lubrifikuese, diametric I korrektuar I njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60 °C | µm                      | -                | 460        | EN ISO 12156-1                               |
| Viskozitetinë 40 °C   | mm <sup>2</sup> /s      | 2,00             | 4,50       | EN ISO 3104                                  |

|   |                          |    |                        |             |
|---|--------------------------|----|------------------------|-------------|
| Distilimi <sup>h,i</sup><br>distilati që vlon në<br>250°C,%(v/v)<br>distilati që vlon në 350<br>°C,%(v/v)<br>distilati që vlon në 95 % (v/v)  | % (V/V)<br>% (V/V)<br>°C | 85 | < 65<br><br><b>360</b> | EN ISO 3405 |
| Shënim : Kërkesat me shkronja të zeza i referohen Direktivës Europiane për lendët Djegëse 98/70/EC {1}, duke përfshirë Amendamentin 2013/17//EC {2} dhe Amendamentin 2009/30/EC [8] |                          |    |                        |             |

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

Plotësimi i kërkesave të mësipërme, përvec deklaramit nga ana e Operatorit Ekonomik, do të shoqërohen edhe me flet – analizën përkatëse e cila do të konsiderohet e rregullt dhe e vlefshme, vetëm nëse analiza është kryer nga një laborator shtetëror apo i autorizuar i tij, dhe në përputhje me Standartin SSH EN 590:2013+A1:2017 ose ekuivalente(te rinovuar) me certifikaten e njohur nga Standartet shqiptare SSH EN 590:2022.

1.1 Operatori Ekonomik duhet të jetë i paisur me certifikatën ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente me të.

1.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqisë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka importuar dhe /ose treguar karburante sipas standardeve të legjistacionit.

**Argumentimi:** Ky kriter është i rëndësishëm, pasi garanton Ak-ne që Operatori Ekonomik ofertues ofron cilësinë duke respektuar standartet Ligjore si dhe respekton normat dhe të gjitha masat mbrojtëse duke ofruar furnizim cilësor si dhe Operatori Ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

1.3 Operatori Ekonomik duhet të pajisë Autoritetin Kontraktor me sasinë e tollonave ose kartes elektronike të naftës të barazvleshme me sasinë e kërkesës së Autoritetit Kontraktor dhe faturës orgjinale të lëshuar prej tij. E cila merret në dorëzim nga personi i autorizuar i AK nepermjet tollonave ose kartes elektronike.

1.4 Duhet të ketë stacione të tregtimit me pakicë të karburantit (me Shërbim 24 orë, cdo ditë të javës) brenda territorit të Bashkis Lushnje, të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (Kontratë noteriale qeraje, akt pronësie, të pasqyruara ne ekstratin e QKB- së)  
Ofertuesi duhet të marre përsipër dhe garantojë gjithcka sa me sipër të cilesojë, vendndodhjet dhe adresat e sakta të tyre, numrat e telefonit dhe personi i kontakti.

**Argumentimi:** Operatori Ekonomik fitues duhet të ketë pikë furnizimi me pakicë brënda territorit të Bashkisë Lushnje për ushtrimin e aktivitetit, pasi Shoqëria Rajonale Ujësjeselles Kanalizime Lushnje ofron shërbim vetëm brënda këtij territori dhe nuk do ishte në interesin AK që mjetet të shkojnë të furnizohen jashtë territorit të Bashkisë, pasi pjesa më e madhe e karburantit do shkonte për transportin e mjeteve dhe jo për kryrjen e punimeve të ndryshme.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Njesia e Prokurimit**

**Serxhjo Zylali**

**Ferdinant Gjermeni**

**Denisa Sina**